

KOSOVË
2015

RAPORTI VJETOR

GJENDJEN E

FILANTROPISË

Hulumtim

Beograd 2016

°catalyst

Fondacioni Catalyst
Takovska 38, Beograd, Serbi

Përgatitur nga:
Jellena Bekçiq

Redaktorë:
Alleksandra Vesiq Antiq
Nathan Koeshall

Mbështetja e të Dhënave:
Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ)

Dizajni grafik:
Tatjana Negiq Paunoviq

Përkthimi në Shqip:
Emina Demiri

Beograd, 2016

Raporti vjetor mbi gjendjen e filantropisë në Kosovë për vitin 2015 është pjesë e një nisme më të gjerë për të promovuar dhe stimuluar filantropinë në rajon, që udhëhiqet nga Fondacioni Catalyst. Hulumtimi që i parapriu dhe ky raport janë realizuar nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkan), falë përkrahjes zemërgjere të ofruar nga Fondacioni C.S. Mott dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, Zyres Gjermane të Fondit Marshall të Shteteve të Bashkuara apo partnerëve të saj.

Përmbajtja

Hyrje

- 4 Parafjala
- 6 Terminologjia e shfrytëzuar në raport
- 7 Përmbledhje

1. Pasqyrë e ërgjithshme

- 11 Niveli i aktivitetit filantropik në Kosovë
- 12 Shpërndarja gjeografike e dhurimeve

2. Pasqyrë e indikatorëve kryesorë që ndërlidhen me filantropinë në Kosovë

- 2.1 DONATORËT**
- 15 Vlera e donacioneve
- 16 Donacionet sipas llojit të donatorëve
- 19 Profilët e llojeve më të shpeshta të donatorëve

- 2.2 ME ÇFARË QËLLIMI BËHEN DONACIONET NË KOSOVË?**
- 21 Cilat tema janë të rëndësishme për donatorët në Kosovë?
- 23 Përdorimi i donacioneve

- 2.3 KUSH ËSHTË MBËSHTETUR NGA DONATORËT NË KOSOVË?**
- 25 Kush është besuar si përfitues i donacioneve?
- 28 Kush përfiton nga donacionet?

- 2.4 SI REALIZOHET DHURIMI NË KOSOVË?**
- 30 Çfarë dhurohet?
- 31 Mënyrat e ngritjes së fondeve
- 33 Mbulimi medial

3. Shtojcat

- 36 *Shtojca 1: Metodologjia*
- 37 Faktorët dhe treguesit që tregojnë shkallën e zhvillimit të filantropisë
- 38 *Shtojca 2: Ndryshimet në kuadrin ligjor-fiskal*

Parafjala

Miq të nderuar,

Catalyst Balkans ka kënaqësinë që të paraqes para jush Raportin Vjetor mbi Gjendjen e Filantropisë në Kosovë për vitin 2015. Ngjashëm si edhe në vitin 2014, ky raport do të paraqes të dhënat për vitin 2015 dhe, kurdo që një gjë e tillë është e mundshme, do të ofrojë indikacione mbi trendet e dhurimeve për indikatorë të caktuar. Ne shpresojmë se këto të dhëna do t'i konsideroni si të dobishme dhe interesante për vlerësimin e nivelit të dhurimeve dhe zhvillimit të filantropisë në Kosovë.

Kosova mund të mburret me faktin se niveli i përgjithshëm i dhurimeve në vitin 2015 ka shënuar rritje në krahasim me atë të vitit 2014, edhe në kuptim të numrit të rasteve të dhënies edhe në atë të vlerës së donacioneve. Supozohet se numri i dhurimeve në vitin 2015 e ka tejkaluar dyfishin e dhurimeve në vitin 2014, me mbi 3.9 milionë euro të dhuruara për qëllime të ndryshme tek pranues e grupe përfituese të ndryshme.

Viti 2015 gjithashtu ka shënuar ngritje të nivelit të të dhuruarit nga qytetarët, ngritje të vazhdueshme të përkrahjes për arsimin, ngritje të vlerës së donacioneve që kanë për synim sektorin jofitimprurës, një gamë paksa më të zgjeruar të grupeve përfituese dhe transparencë të shtuar. Megjithatë, vlera e donacioneve në drejtim të shtetit këtë vit ka shënuar rënie të theksuar. Zbutja e varfërisë si qëllim vazhdon të qëndrojë në majë të qëllimeve, ndërsa edhe gama e qëllimeve në përgjithësi është relativisht e kufizuar në krahasim me vendet tjera. Niveli i përkrahjes së njëhershme mbetet i lartë, duke qenë se mbi 74% të donacioneve shfrytëzohen për përkrahje humanitare, furnizime, trajtime mjekësore dhe banim individual. Donacionet që mund të kenë efekte afatgjata kanë mbetur në nivel të vitit 2014 (17.7%) dhe vazhdojnë të jenë të orientuara nga blerja e pajisjeve dhe investimet kapitale.

Në përgjithësi, edhe pse ka hapësirë për mirësimi, kryesisht në kuptim të zgjerimit të gamës së qëllimeve dhe grupeve përfituese, si dhe për ngritje të nivelit të dhurimit strategjik dhe të transparencës në raportim, gjatë vitit 2015 filantropia kosovare kryesisht u përshkua me zhvillime pozitive.

Catalyst do të vazhdojë të monitorojnë dhe raportojë mbi ndryshimet dhe trendet e filantropisë në Kosovë dhe në rajon. Ne besojmë se matja e filantropisë dhe paraqitja e të dhënave, trendeve dhe shembujve pozitivë mund t'u kontribuojë ndryshimeve pozitive në forma të ndryshme dhe t'u ndihmojë njerëzve që ta kuptojnë potencialin e filantropisë.

Në fund të themi edhe ca fjalë për metodologjinë: këtë vit raporti është hartuar duke shfrytëzuar bazën e të dhënave të **GivingBalkans** të zhvilluar nga Catalyst në vitin 2013 e të cilën ne vazhdojmë ta azhurnojmë. Me kënaqësi të madhe mund të themi që kjo bazë e të dhënave përbën

burimin më të besueshëm¹ sa u përket donacioneve vullnetare në Kosovë dhe rajon. Në mungesë të të dhënave zyrtare, për **GivingBalkans**, Catalyst përdorë metoda alternative të grumbullimit të të dhënave, kryesisht përmes raporteve mediatike dhe burimeve tjera të të dhënave në dispozicion². Edhe pse kjo metodologji³ ka kufizime të caktuara, ne besojmë se hulumtimi ynë do të ofrojë qasje në aspektet më të rëndësishme të dhurimit vullnetar sepse të dhënat e grumbulluara, edhe pse nuk janë gjithëpërfshirëse, ofrojnë indikatorët minimal relevantë që mund të shfrytëzohen si indikatorë të **shkallës së zhvillimit të filantropisë** në vend.

Të dhënat në këtë raport janë grumbulluar duke monitoruar mediat elektronike të shtypura dhe online në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në Kosovë, nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2015. Gjatë kësaj periudhe, janë proceduar 758 regjistrime të donacioneve nga të gjitha llojet e donatorëve, nga të cilat 468 ishin raste unike të regjistruara. Numri i gjithmbarshëm i rasteve të regjistruara dallon nga ai i donacioneve, sepse disa media mund të kenë raportuar për të njëjti donacion.

Ne duam t'ju falënderojmë juve dhe të gjithë ata që na kanë ndihmuar në përgatitjen e këtij raporti: të gjithë ata që kanë marrë pjesë në filantropi dhe të gjithë ata kontributi i së cilëve mundëson zhvillimin e mëtejshëm të metodës dhe metodologjisë sonë për grumbullimin e të dhënave. Krejt në fund, duam të falënderojmë stafin e Catalyst Balkans dhe FIQ të cilët kanë asistuar në grumbullimin e të dhënave dhe procesimin e tyre dhe ata të cilët na anë përkrahur në kompletimin e këtij raporti.

Çdo të mirë deri në publikimin e raportit të vitit 2016,

Catalyst Balkans

1 Edhe pse të dhëna potencialisht më të besueshme mund të gjenden pranë autoritetit tatimor (për shkak se subjektet juridike gëzojnë përfitime të caktuara tatimore në të gjitha shtetet e rajonit), nga këto autoritete nuk është e mundshme që të nxirren të thënat e sakta që ndërlidhen me donacionet.

2 Raportet e organizatave që kanë pranuar donacione dhe raportet e kompanive për donacionet.

3 Informatat e detajuara mbi metodologjinë tonë janë ofruar në pikën 3.1.

Terminologjia e shfrytëzuar në raport

Për ta kuptuar më lehtë raportin, në vijim janë disa përkthime të terminologjisë së shfrytëzuar në të.

Rast	Raste/shembuj unikë të verifikuar të grumbullimit të donacioneve. Mund të përfshijë disa donacione (për shembull, rast mund të jetë edhe një fushatë në të cilën individët mbledhin para për trajtimin mjekësor të dikujt).
Donatorë	Persona dhe/ose entitete ligjore që japin si donacion para të gatshme, kohë, shërbime, mallra. Ata ndahen në disa lloje për të lehtësuar kështu monitorimin e trendeve
Donatorë Publiku i gjerë	Numër i madh individësh që nuk mund të identifikohen me emër.
Donatorë Mix	Raste në të cilat nuk është i mundur klasifikimi i donatorëve, do të thotë në rast janë përfshirë disa lloje donatorësh.
Donatorë Individual	Donatorët mund të identifikohen si individë.
Donatorë Sektori i Biznesit	Përfshin kompanitë (me mbi 50 të punësuar), fondacionet korporative dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (me më pak se 50 të punësuar).
Donatorë Fondacione Private	Fondacionet e themeluara nga individë privatë apo një kombinim i entiteteve private dhe juridike.
Donacion	Rast unik i dhënies, pa kompensim (të parave, mallrave, shërbimeve, apo kohës).
Ndarja	Metoda statistikore që shfrytëzon përqindjen e të dhënave të njohura për të kalkuluar se si do të ishte gjendja po të ishin të njohura 100% të të dhënave. Ndarja rezulton me supozim e jo me vlera absolute.
Filantropia	Dhënia për qëllim të mirë, do të thotë dhënia vullnetare e parave, mallrave, kohës apo shërbimeve për t'u ndihmuar personave në nevojë dhe për të ngritur mirëqenien sociale.
Përfituesit përfundimtarë	Grupet e synuara që përfitojnë nga një donacion. Për shembull, nëse pranuese e donacionit është një shkollë, përfitues janë fëmijët që vijnë në mësim në të.
Qëllimet e dhurimit	Qëllimet për të cilën jepen donacionet, siç janë shëndetësia, arsimi, etj.
Pranuesit e donacioneve	Personat fizikë dhe/ose juridikë që pranojnë donacionin nga një donator. Në të shumtën e rasteve donacionet më pas i barten dikujt tjetër.
Sektori i biznesit	Sektori i biznesit përfshin kompanitë (me mbi 50 të punësuar), fondacionet korporative dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (me më pak se 50 të punësuar).
Shfrytëzimi i donacionit	Tregon se si është shfrytëzuar donacioni, për shembull për investime kapitale, blerje të një pajisjeje, ofrim të shërbimeve, sigurim të të mirave materiale dhe konsumuese, e të ngjashme.

Simboli



Kuptimi
Rritje në krahasim me vitin paraprak.



Rënie në krahasim me vitin paraprak.



Pa ndryshim në krahasim me vitin paraprak.



Ndryshimi është më i vogël se 1% në krahasim me vitin paraprak, prandaj është statistikisht i ngjizhueshëm.

Përmbledhje

PASQYRË E PËRGJITHSHME

Vlerësimi i të dhënave të filantropisë në vitin 2014 dhe 2015 vë në pah dy ndryshime pozitive: ngritjen e vlerës së donacioneve dhe numrin e rasteve të dhurimit.

Të dhënat në dispozicion tregojnë se mbi 3.9 milionë euro janë dhënë në Kosovë për qëllime filantropike gjatë vitit 2015.

Numri mesatar i rasteve është rritur dukshëm nga 17 për muaj (në vitin 2014) në 39 për muaj (në vitin 2015).

Rrjedhimisht, donacioni mesatar për qytetar të Kosovës gjithashtu është rritur lehtë, nga 1.9 euro në 2.1 euro (në vitin 2015).

Në pjesën vijuese do të ofrojmë një pasqyrë të shkurtër të disa prej indikatorëve më të rëndësishëm që bashkërisht paraqesin filantropinë në Kosovë.

TRENDET E KRAHASUARA ME VITIN 2014

Shuma e supozuar e donacioneve: 3.976 mil. €

Rritje prej 11.5% në krahasim me 2014

Numri i rasteve të regjistruara: 468

Donacioni mesatar për kokë Banori: 2.1 €



FILANTROPIA NË VITIN 2015

DONATORËT MË AKTIVË

Në vitin 2015, publiku i gjerë përbënte kategorinë donatore me përqindjen më të lartë të rasteve, e cila pati rritje prej mbi 23% në krahasim me vitin paraprak. Edhe pse kategoria e individëve vazhdon të rangohet e dyta, ajo ka shënuar rritje prej mbi 10%, ndërsa sektori i bizneseve vazhdon të mbajë të njëjtin nivel të dhurimit si në vitin 2014.

DONATORËT MË AKTIVË:

Publiku i gjerë: 49.1%

Individët: 21.6%

Sektori i biznesit: 10.5%



VLERA E DONACIONEVE SIPAS LLOJIT TË DONATORIT

Kur i rangojmë donatorët sipas vlerës së regjistruar të donacioneve të tyre, sërish e kuptojmë se donatorët individualë i prijnë listës, përcjellë nga sektori i biznesit në vend të dytë dhe kategorisë individuale dhe shoqatave në të tretin.

Në krahasim me vitin 2014, vlera e donacioneve nga publiku i gjerë është ngritur për 25.6%, ndërsa investimet nga sektori i bizneseve, donatorët individualë dhe shoqatat ka pësuar rënie.

RANGIMI I DONATORËVE SIPAS SHUMËS SË DONACIONEVE:

Publiku i gjerë: 38.2%

Sektori i biznesit: 31.2%

Individët: 14.8%



QËLLIMET KRYESORE TË DONACIONEVE

Katër qëllimet kryesore që kanë pasur përkrahje të vazhdueshme janë zbutja e varfërisë, përkrahja për grupe të marginalizuara, shëndetësia dhe arsimi, tek të cilat janë orientuar mbi 88% të të gjitha rasteve.

Përderisa përkrahja për këto katër grupe kryesore ka pasur lëkundje, ndryshimet kanë qenë relativisht të vogla në krahasim me vitin 2015, ndërsa në shumicën e vendeve tjera përkrahja për këto çështje të rëndësishme ka shënuar rënie.

Vlen të theksohet se përkrahja për këto katër qëllime përbën 88% të përkrahjes së gjithmbarshme, që nënkupton se ka qëllime tjera të cilat ende nuk gëzojnë përkrahje filantropike. Për më tepër, gama e qëllimeve të përkrahura në Kosovë mbetet e kufizuar në krahasim me vendet tjera.

QËLLIMET MË TË PËRKRAHURA

Zbutja e varfërisë: 50.9%

Përkrahja për grupe
Të marginalizuara: 15.8%

Shëndetësia: 14.5%

Arsimi: 7.3%

SHFRYTËZIMI I DONACIONEVE

Në vitin 2015 përqindja e rasteve në Kosovë kur përkrahja ka qenë e natyrës së njëhershme (ndihma humanitare, përkrahja për trajtim mjekësor të individëve (më së shpeshti fëmijëve), dhe mallrat dhe materialet për punën e organizatave) ka shënuar rritje, ndërsa përkrahja afatgjatë (përkrahja që mund të prodhojë efekte afatgjata, si pajisjet, investimet kapitale, bursat, ngritja e vetëdijes, ofrimi i kapitalit nismëtar dhe të ngjashme), kanë mbetur në të njëjtin nivel si në vitin 2014.

Si edhe në vendet tjera dhe vitet paraprake, sektori i bizneseve vazhdon të udhëheqë në kuptim të ofrimit të përkrahjes afatgjatë.

SHFRYTËZIMI I DONACIONEVE

Përkrahja afatgjatë: 17.7%

Përkrahja e njëhershme: 74.4%

SUBJEKTET PRANUESE

Rangimi i llojeve të subjekteve pranuese sipas përqindjes së rasteve të regjistruara nuk ka ndryshuar fare në krahasim me vitin e kaluar. Është gjithashtu me rëndësi të theksohet se niveli i interesit të llojeve të ndryshme të pranuesve ka mbetur i të njëjti nivel, duke qenë se ndryshimet nuk janë më të mëdha se 1%.

Në pothuajse 95% të rasteve të regjistruara përkrahja është orientuar drejt tri llojeve të pranuesve: individëve/familjeve, organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve. Përveç këtyre, autoritetet lokale dhe entitetet fetare si pranues të donacioneve kanë pasur të njëjtin nivel interesi me vitin 2014.

PRANUESIT E DONACIONEVE (sipas numrit të rasteve):

Individë/familje: 72.0%

Organizata jofitimprurëse: 12.0%

Institucione: 10.9%

Autoritete lokale/nacionale:
1.0%

Nëse shqyrtojmë vlerën e donacioneve (kundrejt shumave të regjistruara), ka mjaft ndryshime: vlera e donacioneve për individë dhe familje është ngritur me mbi 20%, përkrahja për organizata jofitimprurëse gjithashtu është rritur ndjeshëm (me 11.3%), ndërsa institucionet kanë pësuar rënie të theksuar me 22.8% më pak donacione në kuptim të vlerës.

Autoritetet lokale dhe nacionale ishin e vetmja instancë që vazhdon të mbajë nivelin e vitit të kaluar.

PRANUESIT E DONACIONEVE (sipas vlerës së donacioneve të regjistruara)

Individë/familje: 61.5%

Organizata jofitimprurëse:
23.7%

Institucione: 11.4%

Autoritete lokale/nacionale:
0.9%

SHTETI SI PRANUES

Shteti është pranues në rastet kur pranues janë autoritetet dhe institucionet lokale dhe/ose nacionale.

Të dhënat për vitin 2015 paraqesin të njëjtin numër të rasteve kur donacionet janë orientuar nga institucionet shtetërore, por vlera e tyre ka pësuar rënie.

Prandaj, jo sikur në një sërë vendesh tjera të rajonit, shteti i Kosovës nuk paraqitet si pranues i shumave të theksuara të donacioneve të regjistruara filantropike.

SHTETI SI PRANUES I DONACIONEVE

% raste të regjistruara:
11.9%

% para të dhuruara sipas shumës
së regjistruar të donacionit:
12.3%

PËRFITUESIT FUNDORË

Kur i shqyrtojmë kategoritë e përfituesve fundorë, vërejmë se në vitin 2015 njerëzit në nevojë ekonomike vazhdojnë të kryesojnë listën. Përderisa përqindja e përkrahjes për të tri grupet përfituese - njerëzit në nevojë, njerëzit me probleme shëndetësore dhe njerëzit me aftësi të kufizuara - ka ndryshuar pak, këto lëkundje nuk janë të theksuara.

Ndryshim i theksuar megjithatë vërehet në rritjen e përkrahjes për njerëzit nga komunitetet lokale (njerëz nga një vise të caktuara). Pas një rënie në vitin 2014, përkrahja për këtë grup përfituesish është kthyer në nivel të vitit 2013, duke dëshmuar se viti 2014 ishte përjashtim.

Edhe pse përkrahja për grupet përfituese kryesore arrinte në 84.4% të vlerës së gjithmbarshme, është inkurajues fakti që lista e grupeve përfituese që u përkrahën këtë vit është zgjeruar për të përfshirë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, të papunësuar dhe prindër të vetëm.

RANGIMI I GRUPEVE PËRFITUESE MË TË PËRKRAHURA:

Në nevojë ekonomike: 54.7%

Nga komunitetet lokale: 13.2%

Me probleme shëndetësore:
9.4%

Persona me aftësi të kufizuara:
7.1%

Disa karakteristika të Filantropisë në Kosovë gjatë vitit 2015:

- ★ Përkundër faktit se situata ekonomike mbetet e rëndë, trendi pozitiv në rritjen e numrit të rasteve dhe vlerës së gjithmbarshme të donacioneve ka vazhduar.
- ★ Në kuptim të llojit të donatorëve, popullata (në formë të dhurimit nga publiku i gjerë) jo vetëm që ka mbetur donatori më aktiv gjatë vitit 2015, por ka dhënë më shumë se më parë. Sektori i biznesit ka vazhduar me të njëjtin nivel të aktivitetit por ka dhënë më pak, ndërsa individët e kanë shtuar aktivitetin por kanë dhënë më pak.
- ★ Kur vlerësojmë dhurimet nga diaspora, e shohim se përqindja e rasteve është rritur dukshëm në krahasim me vitin paraparak. Në vitin 2015, 37.8% të të gjitha rasteve vinin nga diaspora. Njëkohësisht, vlera e gjithmbarshme e donacioneve nga diaspora, në krahasim me llojet tjera të donatorëve, ka rënë në 23.3%.
- ★ Katër qëllimet kryesore që gëzuan përkrahje vazhduan të jenë zbutja e varfërisë, përkrahja e grupeve të marginalizuara, shëndetësia dhe arsimimi, me mbi 88% të rasteve të orientuara drejt këtyre qëllimeve. Zhvillim pozitiv ishte rritja e përkrahjes për arsim, që dallon në krahasim me shtetet tjera të rajonit. Njëkohësisht, një sërë temash që dresohen nga donatorët vazhdojnë të gëzojnë përkrahje të kufizuar dhe prandaj vazhdojnë të konsiderohen si jo të rëndësishme në kuptim të përkrahjes filantropike.
- ★ Përkrahja e njehershme mbizotëron në Kosovë. Përveç kësaj, megjithatë, trendi i të vepruarit në mënyrë më strategjike tek sektori i biznesit ka vazhduar edhe në vitin 2015.
- ★ Në vitin 2015, pothuajse 95% të rasteve të regjistruara ishin të orientuara drejt individëve dhe familjeve, organizatave dhe institucioneve jofitimprurëse. Individët dhe familjet kryesojnë listën edhe për nga numri i rasteve dhe për nga vlera e donacioneve.
- ★ Organizatat jofitimprurëse kanë shënuar rritje të përkrahjes këtë vit. Edhe pse numri i donacioneve ka mbetur i ngjashëm me atë të vitit të kaluar, vlera e donacioneve është rritur dukshëm. Përveç kësaj, disa organizata kanë krijuar partneritete me sektorin e biznesit, kanë marrë donacione të shumëfishta dhe janë përmendur në media.
- ★ Në krahasim me vitin 2014, përkrahja për shtetin (institucionet dhe autoritetet lokale dhe nacionale) ka rënë dukshëm në kuptim të vlerës së donacioneve të regjistruara.
- ★ Grupet kryesore përfituese kanë mbetur të pandryshuara. Edhe pse niveli i përkrahjes për tri grupe përfituese kryesore – njerëzit në nevojë, personat me probleme shëndetësore dhe personat me aftësi të kufizuara – ka ndryshuar pak, dallimet janë të neglizhueshme. Ndryshimi më i theksuar ishte shtimi i përkrahjes për persona nga komunitetet lokale (të viseve të caktuara), duke arritur përkrahjen e vitit 2013, pas një rënie të theksuar në vitin 2014. Është inkurajuese që lista e grupeve përfituese që marrin përkrahje këtë vit është zgjeruar dhe ka përfshirë persona nga komunitetet pakicë, të papunësuarit dhe prindërit pa bashkëshortë.
- ★ Në fund, por jo edhe për nga rëndësia, transparenca e të dhënave është më e mirë se në vitin 2014. Përqindja e raporteve mediatike që paraqesin vlerën e donacionit është rritur nga 21.5% në vitin 2014, në 30.1% në vitin 2015, duke u kthyer sërish në nivele të vitit 2013 (pas rënies në vitin 2014).


Në përgjithësi, edhe pse ka hapësirë për përmirësim, një sërë zhvillimesh negative mund të vërehen në vitin 2015, siç janë rritja e numrit të rasteve dhe vlerës së donacioneve, interesi më i madh në arsim, shtimi i përkrahjes për organizatat jofitimprurëse dhe zgjerimi i gamës së grupeve përfituese të përkrahura dhe shtimi i nivelit të transparencës.

Pasqyrë e përgjithshme | 1

Niveli i aktivitetit filantropik në Kosovë | 1.1

Ekzistojnë 468 raste të regjistruara filantropike të ofrimit të parave të gatshme dhe/ose mallrave në Kosovë gjatë vitit 2015.

NR. I RASTEVE PER MUAJ



Në këtë kuptim, trendi i parë që duhet theksuar është shtimi i numrit të rasteve të regjistruara në krahasim me vitin 2014. Në vitin 2014 janë regjistruar mesatarisht 17 raste në muaj, ndërsa në vitin 2015 numri ka arritur mbi dyfishin – 39 në muaj. Në krahasim me vendet tjera, Kosova ka shpërndarje më të pazakontë stinore që karakterizohet me rritje në prill dhe maj dhe gjatë muajve të verës dhe me rënie gjatë festave të fundvitit.

NUMRI MESATAR I RASTEVE PËR MUAJ



1.2| Shpërndarja gjeografike e dhurimeve

Analiza e aspektit gjeografik të donacioneve këtë vit në Kosovë shfaqë një shpërndarje relativisht të barabartë sipas rajonit. Përjashtim nga ky rregull përbën Prishtina e cila, përkundër rënies së numrit të rasteve, paraqet rajonin në të cilin më së shpeshti dërgohen donacionet (30.3%). Përjashtimet tjera ishin Mitrovica dhe Ferizaj, që kishin përqindje më të lartë të donacioneve në vitin 2015, dhe rajoni i Pejës që kishte rënie të theksuar në vitin 2014 (nga 13.6% në vitin 2014, në 3.3% në vitin 2014) dhe me 3.2% në vitin 2015 vazhdon të jetë rajoni me përqindjen më të ulët të rasteve.


Përqindja më e lartë e donacioneve në vitin 2015 ka mbuluar ose tërë Kosovën ose disa rajone; përqindja e donacioneve në këtë kategori (nga tërë Kosova) është rritur nga 11.5% në vitin 2014 në 14.1%. Përqindja e donacioneve nga jashtë Kosovës, do të thotë të njerëzve që jetojnë në vende tjera, gjithashtu është ngritur nga 1.9% në vitin 2014 në 4.1%.

Si përmbledhje, donacionet brenda Kosovës i ishin ndarë 73 komuniteteve lokale të ndryshme në 43 komuna.

Në përgjithësi mund të vërehen disa trende: shtimi i vazhdueshëm i donacioneve në rajonin e Ferizajt, vazhdimi i rënies në rajonin e Gjilanit dhe ngritja e kategorisë së donacioneve nga Kosova. Përveç kësaj, do të jetë interesante të shihen arsyet për rënien e theksuar të donacioneve në rajonin e Pejës gjatë dy viteve të fundit.


TRENDET E SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (sipas % të rasteve)	2013		2014		2015
Ferizaj	6.2%	↗	8.6%	↗	12.2%
Gjakovë	6.2%	↘	4.3%	↗	6.8%
Gjilan	13.6%	↘	11.5%	↘	8.8%
Mitrovicë	9.9%	≈	10.5%	↗	15.4%
Pejë	13.6%	↘	3.3%	≈	3.2%
Prishtinë	32.1%	↗	39.2%	↘	30.3%
Prizren	7.4%	↗	9.1%	↘	5.1%
Nga Kosova	3.7%	↗	11.5%	↗	14.1%
Jashtë Kosovës	1.2%	≈	1.9%	↗	4.1%

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E DHURIMEVE SIPAS RAJONEVE
(sipas % të rasteve)



Emërtimi i Kosovës në këtë dokument nuk ndikon në qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të KB – së dhe me mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E DHURIMEVE, SIPAS KOMUNAVE PRANUESE (% e rasteve)



Nuk ka raste të regjistruara	1 - 9 0 - 2.5% % e rasteve	10 - 20 2.6 - 5.0% % e rasteve	21 - 27 5.1 - 7.0% % e rasteve	28 - 35 7.1 - 10.0% % e rasteve	> 36 > 10% % e rasteve

Emërtimi i Kosovës në këtë dokument nuk ndikon në qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të KB – së dhe me mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Pasqyrë e indikatorëve kryesorë | 2 që ndërlidhen me filantropinë në Kosovë

Donatorët | 2.1

Vlera e donacioneve | 2.1.1


Nga 468 donacione (thirrje, raste, raporte dhe të ngjashme) të indeksuara, 30.1% kanë pasur të ndërlidhur një vlerë monetare, që paraqet rritje në krahasim me 21.5% të tilla vitin 2014. Vlera e gjithmbarshme e donacioneve të raportuara nga mediat e të cilat kanë qenë të verifikueshme nga burime tjera, ishte pak mbi 1,597,000 euro.

Përkundër faktit që pak më shumë se një e treta e të dhënave të regjistruara kishin vlerë donacioni, në bazë të nxjerrjes së një vlerësimi të matur mund të arrihet tek supozimi që vlera e donacioneve për qëllime bamirëse në Kosovë në vitin 2014 ishte së paku 3.943 milionë euro. Grafikoni më poshtë paraqet vlerën e regjistruar dhe verifikuar në euro, si dhe vlerën e supozuar në bazë të nxjerrjes së shumave të regjistruara.

Duke qenë se vlerat e regjistruara dhe supozuara kryesisht përbëhen nga donacione në para të gatshme dhe faktin që mbetet e vështirë që të sigurohet një përqindje më e lartë e të dhënave, me arsye mund të supozohet që vlera e gjithmbarshme e donacioneve ishte dukshëm më e lartë, e madje edhe më e lartë se sa shuma e parashikuar në këtë dokument.

Është me rëndësi të theksohet trendi i vazhdueshëm i rritjes së vlerës së donacioneve, një zhvillim i cili përkon me rritjen e vazhdueshme të numrit të donacioneve gjatë tri viteve të fundit.

SHUMAT E DHURUARA
(në milionë euro)



— Të dhënat e verifikura
— Të dhënat e përafërta

TRENDET SIPAS VLERËS SË SUPOZUAR TË DONACIONEVE
(në milionë euro)




2.1.2| Donacionet sipas llojit të donatorëve

Ne hulumtojmë dy aspekte të dhënies së ndihmave për të kuptuar më mirë veprimtarinë e donatorëve: numrin e rasteve dhe shumën e regjistruar të donacioneve. Këto dy aspekte shpesh na dmonstrojnë se donatorët më aktivë (që japin numrin më të madh të donacioneve) nuk janë ata që japin shumat më të mëdha.

Në vitin 2015, numri më i madh i donacioneve është dhënë nga publiku i gjerë (donacione gjatë fushatave dhe përgjigje në thirrjet për përkrahje/ndihmë), përcjellë nga donatorët individualë (individë që kanë dhuruar mjete, në rastet kur mund të identifikohet donatori) dhe sektori i bizneseve. Pjesëmarrja nga donatorët tjerë ishte pak mbi 18%.

Megjithatë, pamja ndryshon në një masë kur i rangojmë donatorët sipas përqindjes së shumës së dhuruar të regjistruar. Publiku i gjerë vazhdon ta kryesojë listën, por sektori i bizneseve kalon në vendin e dytë, duke lënë individët në të tretin. Donatorët e natyrave tjera kanë dhënë më pak se 16% të vlerës së gjithmbarshme të regjistruar.


DONACIONET SIPAS LLOJIT TË DONATORIT (% e rasteve kundrejt % e shumës së regjistruar)



Kur i vlerësojmë këto tri lloje donatorësh (publikun e gjerë, sektorin e bizneseve dhe individët) dhe veprimtarinë e tyre gjatë dy viteve të fundit, ne kemi vërejtur se jo sikur në vitin 2014, donatorët individualë udhëheqin edhe në kuptim të numrit të rasteve dhe vlerës së donacioneve. Këtë vit gjithashtu vërejmë rënie të vlerës së gjithmbarshme të dhuruar nga sektori i bizneseve, ndërsa individët e kanë ngritur pjesëmarrjen e dhurimit, por kanë dhënë si donacion një pjesë më të vogël të totalit.

Megjithatë, ndryshimet e dukshme në përqindje të rasteve dhe vlera e regjistruar e donacioneve kanë pësuar lëkundje gjatë tri viteve të fundit, prandaj nuk mund të nxirret një trend i qartë.

TRENDET KRYESORE NË LLOJET E DONATORËVE 2013 – 2015



DONACIONET NGA DIASPORA

Në vitin 2015, pothuajse 38% të rasteve dhe pak mbi 23% të tërë vlerës së dhuruar ka ardhur nga diaspora. Fondet janë siguruar përmes evenimenteve dhe fushatave/thirrjeve. Shtetet nga të cilat ka ardhur ndihmë e tillë këtë vit përfshijnë: SHBA-të, Suedinë, Zvicrën, Mbretërinë e Bashkuar, Australinë, Austrinë, Francën, Italinë, Gjermaninë, Holandën e madje edhe Islandën.

Shembuj të shkëlqyeshëm të dhurimit afatgjatë individual nga diaspora janë dhuratat e *Milloje Minoviqit dhe Nazmi Bytyqit, të dy me qëndrim në Gjermani*. Z. Minoviq, profesor me profesion, vendosi të përkrahë aktivitetet kulturore në komunitetin e Graçanicës duke dhuruar një veturë (në vlerë prej 5.000 euro) për Shtëpinë e Kulturës në Graçanicë. Në anën tjetër, z. Bytyqi investoi në shëndetësi, duke i dhuruar Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë pajisje mjekësore në vlerë prej 33.000 euro.





SHEMBUJ TË DONACIONEVE TË SEKTORIT TË BIZNESEVE

Shembull i jashtëzakonshëm i dhurimit nga një biznes ishte donacioni i *Bankës Ekonomike të Kosovës* për organizatën *Down Syndrome Kosova*. Qëllimi i donacionit ishte që të ndërtohet një Qendër për Fëmijë me Down Syndrome, si një vend për përkrahje dhe përfshirje të personave me këtë sindrom. Donacioni përbën një dhuratë e cila do t'i kontribuojë në afat të gjatë përkrahjes së këtij grupi të marginalizuar.

Albi Group, Trepça dhe ELKOS Group kanë qenë shumë aktive në përkrahjen e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe fëmijëve me nevoja ekonomike, përmes donacioneve të tyre në formë ushqimi dhe furnizimesh të rregullta.

Sektori i bizneseve ka investuar edhe në shëndetësi. *Kompania Forma Ideale* e ka pajisur Departamentin e Gjinekologjisë në Shtëpinë e Shëndetit në Gjilan me mobilie të reja dhe pajisje të reja për kuzhinë dhe tryezari që shfrytëzohet nga pacientët.

Një tjetër shembull, më pak tipik, ishte ai *Raiffeisen Bank Kosovo*, e cila, në bashkëpunim dhe bashkëorganizim me organizatën "Ide dhe Partneritet," ka implementuar një projekt për arsimimin e komunitetit Rom, Ashkali, Egjiptas, në vlerë prej 31.200 euro.



KAUZAT E NDËRLIDHURA ME MARKETING

Trendi në fjalë quhet "marketingu i ndërlidhur me kauza", d.m.th. dhurimi i një pjese të të ardhurave të kompanisë nga shitja e produkteve, është duke vazhduar përhapjen në tërë rajonin. Marketingu i ndërlidhur me kauzë mund të përbëjë kombinim fitues për të gjitha palët: përderisa kompania nxjerr profit, ajo përkrahë kauza të caktuara dhe, njëkohësisht, ngritë vetëdijen e qytetarëve lidhur me çështjet që kërkojnë përkrahje.

Një fushatë e re marketingu e ndërlidhur me kauzë është lansuar nga *Fondacioni Golden Eagle*, i themeluar nga kompania *Frutex*. Për çdo produkt të shitur, 2 centë janë ndarë për bursa për studentë në Kosovë. Studentët janë përzgjedhur në bazë të kriterëve specifike, përfshirë gjendjen e tyre financiare dhe performansën akademike. Edhe më e rëndësishme dhe paksa e pazakontë është që studentëve me aftësi të kufizuara i është dhënë prioritet.

Përkrahje e vlefshme për të moshuarit erdhi nga kompania *TrePharm*, e cila ka lansuar fushatën përkrahëse për të moshuarit. Tre centë nga çdo produkt i shitur janë ndarë në një fond të themeluar për rinovimin e një shtëpie të pleqve.



DONACIONET NGA INDIVIDË


Në vitin 2015, kemi pasur një shembull të jashtëzakonshëm të donacionit nga individ, në rastin e *Rexhë Zhaklit*, i cili përkrahu Shoqatën e Sindromit Down dhe Shoqatën e Autizmit me nga 75.000 euro për secilën organizatë.

Një donacion tjetër interesant e ka bërë edhe shkrimtari dhe publicisti i njohur *Jusuf Buxhovi*, i cili i dha si donacion 540 libra për libraritë në disa vende, përfshirë Prizrenin dhe Ulqinin.


Profillet e llojeve më të shpeshta të donatorëve | 2.1.3



SEKTORI I BIZNESEVE



PUBLIKU I GJERË



ÇËSHTJET KRYESORE:



- Përkundër rënies në 30.3%, Prishtina ka mbetur rajoni me numrin më të lartë të donacioneve, ndërsa Peja mbetet (për të dytin vit radhazi) rajoni me përqindjen më të ulët të rasteve. Trendet që mund të nënvizohen janë vazhdimi i dhurimit në rajonet e Ferizajt dhe Mitrovicës, rënia e vazhdueshme e nivelit në rajonin e Gjilanit dhe shtimi i vazhdueshëm në kategorinë Nga Kosova.
- Numri i donacioneve është shtuar (për gati 124%) si edhe vlera e regjistruar dhe supozuar e tyre (për 11.5%).
- Në vitin 2015, donatorët më aktivë ishin publiku i gjerë (49.1%), përcjellë nga individët (21.6%) dhe sektori i bizneseve (10.5%).
- Kur shikojmë vlerën e donacioneve, pasqyra është paksa më e ndryshme: publiku i gjerë udhëheq me 38.2% të vlerës së gjithmbarshme të regjistruar, përcjellë nga sektori i bizneseve me 31.2% dhe individët me 14.8%.
- Kur analizojmë dhurimet nga diaspora, përqindja e rasteve duket bindshëm më e lartë se vitin paraprak, duke shënuar ngritje në 37.8%, ndërsa vlera e regjistruar e donacioneve ka rënë në 23.3%.
- Në përgjithësi, ka pasur rritje të vazhdueshme të numrit dhe vlerës së donacioneve gjatë tri viteve të fundit. Donatorët nga publiku i gjerë vazhdojnë të jenë fuqishëm të pranishëm dhe të dhurojnë më shumë, ndërsa angazhimi i sektorit të bizneseve (kompani, fondacione dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme) ka mbetur në të njëjtin nivel në kuptim të frekuencës dhe ka rënë në kuptim të përqindjes së totalit të regjistruar. Megjithatë, nëse i vlerësojmë tri vitet e fundit, këto përqindje kanë shënuar lëkundje, andaj nuk mund të sugjerohet ndonjë trend i qartë.

Me çfarë qëllimi bëhen donacionet në Kosovë? |2.2

Cilat tema janë të rëndësishme për donatorët në Kosovë? |2.2.1


Katër temat kryesore në të cilat janë drejtuar donacionet më 2015 vazhduan të jenë ulja e varfërisë, mbështetja për grupet e marginalizuara, kujdesi shëndetësor dhe arsimit.

Përderisa nuk ka pasur ndryshim të konsiderueshëm në nivelin e mbështetjes për këto tema, është me rëndësi të theksohet se mbështetja për arsimin ka shënuar rritje. Gjersa ende nuk është në nivelin që ishte më 2013, Kosova është një nga vendet e pakta në rajon ku mbështetja për këtë çështje të rëndësishme është rritur.


Gama e temave është ende e kufizuar krahasuar me shumicën e vendeve të tjera; numri i temave madje është ulur në vitin 2015. Prandaj, përderisa trashëgimia është paraqitur si temë e re, zhvillimi i komunitetit dhe zhvillimi ekonomik nuk ishin të pranishme këtë vit¹.

Këtë vit, përqindja e rasteve për të gjitha temat përveç katër të parave ishte 11.5%, që është pak më e lartë se vitin e kaluar. Përderisa besojmë se mbështetja në këto fusha mund të jetë më e lartë se ajo e shënuar nga mediat që apo ishte e mundur që të verifikohet duke përdorur burime të tjera, qëndron fakti se mbështetja për të gjitha çështjet e tjera vazhdon të jetë mjaft e ulët.


TEMAT KRYESORE TË DHURIMEVE (sipas % të rasteve)



ZBËRTHIMI I TEMAVE TË TJERA (sipas % të rasteve)



¹ Kategorija 'të tjera' në diagram përfshinte kryesisht donacionet për qëllime të shumta (gjegjësisht, disa donacione nga i njëjti donator për qëllime të ndryshme).



PIKAT KYÇE:




- Katër temat kyçe të mbështetura ishin: ulja e varfërisë, mbështetja e grupeve të marginalizuara, shëndetësia dhe arsimi. Gjithsej rastet e drejtuara në këto tema arrinin 88.5%.
- Për sa i përket radhitjes së temave kyçe sipas numrit të rasteve, prin ulja e varfërisë, ndërsa mbështetja për grupet e marginalizuara është radhitur më lartë se shëndetësia, ndërsa arsimi ka mbetur në vendin e katërt. Përderisa nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme në nivelin e mbështetjes për këto tema, është me rëndësi të theksohet se mbështetja për arsimin është rritur, duke bërë që Kosova të jetë është një nga vendet e pakta ku mbështetja për këtë çështje të rëndësishme ka shënuar rritje.
- Numri i temave mbeti i kufizuar në krahasim me shumicën e vendeve të tjera të rajonit; numri i temave madje është zvogëluar në vitin 2015. Prandaj, përderisa trashëgimia është paraqitur si temë e re, zhvillimi i komunitetit dhe zhvillimi ekonomik nuk ishin të pranishme këtë vit. Përqindja e rasteve për të gjitha temat e tjera përveç katër të parave ishte 11.5%, që ishte pak më e lartë se vitin e kaluar, por ende mjaft e ulët. Kjo është shenjë se çështjet e tjera ende nuk e kanë fituar vendin e tyre si kauza filantropike në Kosovë.
- Në krahasim me vitin e kaluar, gama e temave të tjera mbeti e kufizuar dhe pothuajse e pandryshuar. Përqindja më e vogël e rasteve ishte e drejtuar për kulturë dhe arti, si dhe trashëgimi, ndërsa një përqindje e vogël e dhurimeve shkoi në zbutjen e efekteve të përmytjeve që ndodhën në Maqedoni dhe Shqipëri.

Përdorimi i donacioneve | 2.2.2

Të dhënat mbi mënyrën e përdorimit të donacioneve jep informata më të thella për atë nëse ato janë ofruar si mbështetje e njëhershme (ndihmë humanitare), apo kishin për qëllim që të ndihmojnë gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për probleme specifike.

Në përputhje me metodologjinë dhe të dhënat e regjistruara, e kemi ndarë përdorimin e donacioneve në tri kategori: mbështetje afatgjate, mbështetje e njëhershme dhe donacioneve për qëllime të panjohura². Një pasqyrë e kategorive të donacioneve është paraqitur në diagramin në vijim.



TRENDET NË PËRDORIMIN E DONACIONEVE, 2013 - 2015 (sipas % të rasteve)

	2013		2014		2015
Mbështetje afatgjate	16.0%	↗	17.7%	=	17.7%
Mbështetje e njëhershme	71.6%	↘	70.3%	↗	74.4%
E panjohur	12.3%	≈	12.0%	↘	7.9%

DHURIMET STRATEGJIKE

Një shembull interesant i dhurimeve strategjike vjen nga *Fondacioni Çifti Buqinca* i themeluar për të mbështetur arsimimin e grave, me synimin specifik të rritjes së numrit të vajzave që ndjekin nivelet më të larta të arsimit dhe kështu i afrohen më shumë perspektivave më të mira ekonomike dhe sociale. Në vitin 2015, fondacioni ka ofruar mbështetje me bursa për më shumë se 40 vajza dhe gra të reja.

Një tjetër shembull vjen nga *korporata IPKO*, e cila ka investuar rreth 50.000 euro në rinovimin e shkollave fillore në Istog, Suharekë dhe Ferizaj.

² Në kuadër të kategorisë “mbështetje afatgjatë” kemi përfshirë: investimet kapitale, pajisjet, investimet në shërbime, bursat (investime në burimeve njerëzore), kërkimin dhe zhvillimin, ngritjen e vetëdijes sociale. Në kategorinë “mbështetje e njëhershme” kemi përfshirë: ndihmën humanitare, donacionet sezonale, trajtimet mjekësore për individë/familje, si dhe materialet dhe artikujt harxhues. Nuk është gjithmonë e mundur që të përcaktohet qëllimi i një donacioni meqë të dhënat në dispozicion, për shembull, mund të tregojë se një institucion/organizatë është mbështetur, por pa specifikuar qëllimin e donacionit.



MBËSHTETJE PËR INDIVIDËT NË NEVOJË – BANIM

Shikuar prapa gjatë tri viteve të fundit, është interesante që të theksohet mbështetja për banim individual për njerëzit në nevojë ekonomike. Duke pasur parasysh edhe numrin edhe vlerën e donacioneve, si krahasimin me të tjerët në rajon, kjo është praktikë tejet specifike për Kosovën.

Kompanitë dhe NVM-të, shoqatat, organet fetare, qytetarët dhe donatorët individualë (vendorë dhe nga diaspora) kanë mbështetur aktivisht dhe në mënyra të ndryshme rindërtimin apo ndërtimin e shtëpive për njerëzit që kanë nevojë për një mbështetje të tillë. Në vitin 2015, pothuajse 13% e rasteve të përgjithshme të dhurimeve janë drejtuar në këtë qëllim.

PIKAT KYÇE:



- Përqindja më e lartë e rasteve në Kosovë në vitin 2015 ka vazhduar të jetë në formën e mbështetjes së njehershme. Ashtu sikurse në vendet e tjera të rajonit, sektori i korporatave vazhdon të jetë më i orientuar në investime strategjike sesa llojet e tjera të donatorëve.
- Analiza e praktikës së dhurimeve gjatë tri viteve të fundit tregon se donacionet e pajisjeve janë bindshëm investimi më i shpeshtë me potencialin e efekteve afatgjate. Pas pajisjeve vijonin donacionet për rindërtimin e ndërtesave (investime kapitale) dhe shërbimet arsimore.
- Donacionet më të shpeshta të njehershme ishin ato për të ndihmë humanitare, furnizime/konsum dhe banim individual dhe trajtime mjekësore.
- Investimet afatgjate kanë mbetur në të njëjtin nivel sikurse në vitin 2014, ndërsa investimet e njehershme kanë shënuar rritje të lehtë. Kjo e fundit mund të shpjegohet për nga mbështetja më e fortë emergjente për popullatën e prekur nga përmytjet që kanë ndodhur në Maqedoni dhe Shqipëri.


Kush është mbështetur nga donatorët në Kosovë? |2.3

Kush është besuar si përfitues i donacioneve? |2.3.1

Subjektet përfituese (shpeshherë të referuar si partnerët) tregojnë se në çfarë mënyre donatorët kanë zgjidhur t'i kanalizojnë donacionet e tyre, duke treguar kështu tërthorazi se ku e mbështetin besimin³.

Më 2015, përfituesit kryesorë ishin individët/familjet, vijuar nga organizatat jofitimprurëse (shoqatat dhe fondacionet) dhe institucionet. Një numër i vogël i donacioneve janë drejtuar për qeveritë lokale/qendrore⁴.


LLOJI I SUBJEKTEVE PËRFITUESE (sipas % të rasteve)



SUBJEKTET PËRFITUESE (% e rasteve)	2013		2014		2015
Individët/familjet	55.6%	↗	71.3%	≈	72.2%
Organizatat jofitimprurëse	22.2%	↘	11.0%	≈	12.0%
Institucionet	17.3%	↘	11.5%	≈	10.9%
Qeveritë lokale/qendrore	1.2%	≈	0.5%	≈	1.1%

³ Përfituesit e donacionit/partnerët përgjithësisht e shpërndajnë më tej mbështetjen tek përfituesit; gjegjësisht, i shfrytëzojnë ato në të mirë të një grupi të posaçëm të synuar.

⁴ Kategoria "të tjera" përfshinte bashkësitë fetare dhe përfituesit e panjohur.



PIKAT KYÇE:



- Në vitin 2015, tri llojet kryesore të subjekteve përfituese sipas % të rasteve ishin individët/familjet (72.2%), organizatat jofitimprurëse (12%) dhe institucionet (10.9%).
- Shikuar nga perspektiva e vlerës së donacioneve, radhitja mbetet e njëjtët, në krye me individët/familjet, vijuar nga organizatat jofitimprurëse dhe pastaj institucionet.
- Kur kombinohen të dhënat për institucionet dhe qeveritë lokale/qendrore (meqë të dy këto kategori janë nën kontrollin e shtetit), mund të shohim se 11.9% sipas numrit të rasteve dhe 12.3% sipas vlerës së donacioneve janë dhuruar për shtetin.
- Krahasuar me vitin paraprak, përqindja e rasteve të drejtuara tek grupet kryesore përfituese ka mbetur në të njëjtin nivel, me një ndryshim prej jo më shumë se 1.0%.
- Nëse kërkojmë trendë në përqindje të vlerës së donacioneve, mund të shohim se përqindja e vlerës së donacioneve për individët/familjet dhe organizatat jofitimprurëse është rritur, përqindja e vlerës së donacioneve për institucionet është ulur, ndërsa niveli i dhurimeve për qeveritë lokale dhe kombëtare ka mbetur pothuajse i njëjtë.

ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE MË 2015



len të përmendet se në vitin 2015 pjesëmarrja në investime në sektorin jofitimprurës kishte mbetur në të njëjtin nivel sikurse ajo e vitit 2014, ndërsa vlera e donacioneve ishte rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2014.

Ndryshe nga viti i kaluar, më 2015 përqindja më e madhe e donacioneve për organizatat jofitimprurëse erdhi nga sektori i biznesit, vijuar nga donatorët individualë dhe donacionet e publikut të gjerë. Në krahasim me vitin e kaluar, niveli i dhurimeve nga bizneset është rritur, por dhurimet e publikut të gjerë kanë rënë ndjeshëm. Dhurimet Individuale për organizatat jofitimprurëse ishte çuditërisht i lartë këtë vit, diçka që nuk është parë më parë.

Ashtu sikurse në periudhën e mëparshme, sektori jofitimprurës në Kosovë çalon prapa vendeve të tjera të rajonit në aspektin e gamës dhe diversitetit të temave për të cilat pranojnë donacione. Gama e temave që janë të mbështetur gjatë dhurimeve për organizatat jofitimprurëse ishte mjaft e kufizuar dhe përfshinte mbështetje për grupet e marginalizuara, sporte dhe kujdes shëndetësor. Situata mjaft të ngjashme kemi hasur kur kemi shqyrtuar grupet e përfituesve përfundimtarë për të cilat organizatat kanë pranuar mbështetje. Këtu përfshiheshin kryesisht njerëzit në nevojë ekonomike, të rriturit dhe fëmijët me probleme të shëndetit fizik dhe njerëz nga gjeografi specifike.


Trendi i rritjes së numrit të organizatave dhe fondacioneve që pranojnë donacione të shumta nga donatorë të ndryshëm ka vazhduar në vitin 2015. Për sa i përket numrit të rasteve, përfituesit kryesorë të donacioneve ishin *SOS Fshati i Fëmijëve në Kosovë*, *Shoqata Humanitare Majka devet Jugovića*, *Shoqata Kombëtare e Kosovës për Autizëm*, *Down Syndrome Kosova* dhe *Veprim për Nëna dhe Fëmijë*. Numri i donacioneve për SOS Fshatin e Kosovës është rritur, ndërsa emri i ri që u shfaq si përfitues i donacioneve ishte *Shoqata Humanitare Majka devet Jugovića*, organizatë mjaft e njohur jofitimprurëse që drejton kuzhina publike.

Përderisa kemi parë shumë shembuj të bashkëpunimit midis organizatave jofitimprurëse dhe sektorit të biznesit, siç është ai në mes të *Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës* dhe *Fondacionit IPKO*, bankës *Reiffeisen* dhe organizatës *Ide* dhe *Partneritet*, si dhe kompanisë *Arizona Ice Tea* dhe *SOS Fshatit të Fëmijëve*, trendi i dhurimeve për organizata kombëtare dhe/apo të qendrës vazhdon tutje. Megjithatë, lansimi i suksesshëm i fushatës për mbledhje të fondeve nga *organizata Mundësia* tek komuniteti i tyre është inkurajues.

2.3.2| Kush përfiton nga donacionet?

Katër grupe kryesore të përfituesve përfundimtarë që u paraqitën më 2015 janë njerëzit në nevojë ekonomike, njerëzit nga një gjeografi specifike, njerëzit me çështje shëndetësore dhe njerëzit me aftësi të kufizuara.

GRUPET PËRFITUESE (# e rasteve)



ZBËRTHIMI I GRUPEVE TË TJERA PËRFITUESE PËRFUNDIMTARE (sipas % të rasteve)

nga 0 - 1%	nga 1 - 2%	nga 2 to 4%
<ul style="list-style-type: none"> • Gratë dhe fëmijë të mbijetuar të dhunës • Njerëzit nga bashkësitë fetare • Të papunët • Prindërit vetëushqyes, • Fëmijët dhe të rinjtë e talentuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Gratë me foshnja • Njerëzit nga vendet e tjera, • Njerëzit nga komunitetet pakicë 	<ul style="list-style-type: none"> • Fëmijët pa kujdes prindëror • Popullata e përgjithshme, • Të moshuarit

TRENDET NË GRUPET KRYESORE TË PËRFITUESVE TË FUNDIT (me % të rasteve)

	2013		2014		2015
Njerëzit në nevojë ekonomike	48.2%	↗	52.9%	↗	54.7%
Njerëz nga gjeografi specifike	14.8%	↘	3.8%	↗	13.2%
Njerëzit me çështje shëndetësore	8.6%	↗	12.9%	↘	9.4%
Personat me aftësi të kufizuara	8.6%	=	8.6%	↘	7.1%

PIKAT KYÇE:




- Tri grupet kryesore të përfituesve përfundimtarë (njerëzit në nevojë ekonomike, njerëz nga një gjeografi specifike dhe njerëzit me çështje shëndetësore) përbëjnë mbi 77% të numrit të përgjithshëm të rasteve të dhurimeve më 2015. Grupi i katërt i përfituesve ishin personat me aftësi të kufizuara.
- Gjatë vitit ka pasur rritje të rasteve të drejtuara ndaj njerëzve në nevojë ekonomike dhe njerëzve nga një gjeografi specifike, ndërsa në të njëjtën kohë përqindja e rasteve për të mirën e njerëzve me çështje shëndetësore dhe personave me aftësi të kufizuara ka pësuar rënie të vogël.
- Përqindja e rasteve të përfitimeve të grupeve të tjera ka shënuar rënie në vitin 2015 dhe totali i tyre arriti në pak më pak se një të pestën e të gjitha rasteve. Megjithatë, është po ashtu e rëndësishme të theksohet se lista e grupeve të përfituese është zgjeruar për të përfshirë njerëz nga komunitetet pakicë, të papunët dhe prindërit vetëushqyes.

2.4| Si realizohet dhurimi në Kosovë?

2.4.1| Çfarë dhurohet?

Analiza gjatë dy viteve të mëparshme ishte konfirmuar me të dhënat nga viti 2015: donatorët preferojnë të dhurojnë në para të gatshme, vijuar nga donacione të mallrave në natyrë, donacione të përziera (para të gatshme dhe në natyrë) si dhe shërbimeve pro-bono. Për fat të keq, nuk janë shënuar raste që përfshijnë vullnetarizëm në vitin 2015.

ÇFARË DHUROHET? (sipas % të rasteve)



PIKAT KYÇE:


- Donacionet në para të gatshme ishin më të shpeshtat (81.8%), që paraqet rritje në krahasim me vitin 2014. Nga ana tjetër, donacionet në natyrë janë paraqitur në një përqindje shumë më të vogël (12.8%).
- Ashtu sikurse në vitet e mëparshme, një përqindje e vogël e rasteve përfshinin shërbime pro-bono.
- Ne besojmë se fakti që nuk janë shënuar raste të vullnetarizmit më 2015 nuk reflekton pasqyrën reale meqë mediat shpeshherë nuk raportojnë për aktivitetet e vullnetarizmit, sepse ato shihen si më pak tërheqëse dhe kompanitë i konsiderojnë si pjesë të strategjisë së tyre të punonjësve dhe kështu nuk i llogarisin si formë të dhurimeve filantropike.

Mënyrat e ngritjes së fondeve | 2.4.2

Për të siguruar një analizë më të lehtë, mënyrat e ngritjes së fondeve janë ndarë në katër kategori: donacionet direkte (rastet në të cilat donatorët kanë përzgjedhur përfituesit e fundit), fushatat/apelet për dhurim, dhurimet gjatë ngjarjeve, dhe thirrjet për aplikim. Të dhënat në dispozicion tregojnë se këtë vit fushata/apelet për dhurim ishin përsëri mënyra më e shpeshtë e dhurimeve, e ndjekur nga donacionet direkte dhe pastaj ngjarjet. Nuk janë regjistruar thirrje për aplikime në Kosovë në vitin 2015.

MËNYRAT E NGRITJES SË FONDEVE

(sipas % të rasteve)

MËNYRAT E NGRITJES SË FONDEVE - 2013 - 2015
(sipas % të rasteve)

2013

2014

2015

Mënyra e ngritjes së fondeve	2013	2014	2015
Fushatat/apelet për dhurim	27.2%	41.1%	47.9%
Donacionet direkte	55.6%	46.9%	42.1%
Ngjarjet	16.0%	11.5%	10.0%
Thirrjet për aplikim	1.2%	0.5%	0.0%



MËNYRAT E NDRYSHME PËR MBLEDHJEN E FONDEVE NË KOSOVË

Mundësia, organizatë nga Mitrovica, lansoi një fushatë të suksesshme për ngritjen e fondeve që ngriti 30,000 euro nga individë dhe biznese për të blerë një mamograf për qendrën shëndetësore lokale.

Një tjetër shembull i fushatës së suksesshme lokale për ngritje të fondeve është ai i Klubit Rotarian në Gjilan. Së bashku me Komunën e Gjilanit, kjo shoqatë organizoi një gala mbrëmje për ngritje të fondeve për studentët në Gjilan dhe ka mbledhur me sukses më shumë se 30.000 euro të cilat u ndanë në formë bursash.

Një shembull interesant dhe inovativ i ngritjes së fondeve vjen nga Muzeu i Kosovës. Muzeu ka organizuar një ekspozitë mobile të quajtur Paraqitje e Muzeut të Kosovës, që është ekspozuar në komunitetet e tërë Kosovës. Të gjitha të ardhurat u drejtuan për mbështetje të SOS Fshatit të Fëmijëve.

Fëmijët dhe të rinjtë në Prishtinë organizuan shitjen e pikturave të tyre në Ditën e Rinisë. Fondet e mbledhura nga shitja i janë dhuruar Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.



PIKAT KYÇE:

- Fushata/apelet për dhurim ishin preferenca e parë për donatorët, që përfaqëson pothuajse gjysmën e numrit të përgjithshëm të rasteve. Ky ishte ndryshim nga viti 2014.
- Donacionet direkte shënuan rënie në numrin e rasteve, siç ndodhi edhe me ngjarjet.
- Në vitin 2015 nuk u shënuan Thirrje për Aplikim. Megjithatë, supozimi ynë (sikurse në vende të tjera dhe vitet e mëparshme) është që ka pasur Thirrje për aplikim por që ato nuk janë raportuar si duhet.


Mbulimi medial | 2.4.3

Siç është paraqitur në diagramet më poshtë, shumica e raporteve të donacioneve janë publikuar në media në internet (75.3%), vijuar nga një përqindje shumë më e vogël në mediat e shkruara (21.9%). Numri më i ulët i raportimeve është transmetuar në mediat elektronike (2.8%). Krahasuar me vitin 2014, kemi vërejtur një rritje shumë të madhe në raportimin në internet, dhe një rënie proporcionale në mediat elektronike dhe të shkruara.


Për sa i përket mbulimit të territorit, 84.8% e raporteve ishin në media kombëtare dhe një përqindje e vogël prej 14.5% të publikuara në mediat rajonale. Vetëm 0.7% e raporteve janë gjetur në media nën-rajonale, të cilat mbulojnë rajonet brenda vendit.

Përveç kësaj, në kuptim të shpeshhtësisë, numri më i madh i raportimeve është publikuar në mediat e përditshme.


LLOJI I MEDIAVE
(sipas % të rasteve)



MBULIMI MEDIAL
(sipas % të rasteve)



RAPORTIMET E MEDIAS SIPAS
SHPESHTËSISË
(sipas % të rasteve)



Siç edhe u konfirmuar nga analiza e të dhënave lidhur me mbulimin medial në vende të tjera, në vitin 2015 mediat gradualisht filluan të raportojnë për aktivitetet filantropike në vendet e tjera të rajonit. Kur flitet për Kosovën, në vitin 2015 rreth 5.5% e raportimeve që kanë përmendur filantropinë në Kosovë janë cekur në mediat e huaja që veprojnë në rajon.

Botasot.info, Telegrafi.com, Indeksonline.net, Koha.net dhe Kosovapress.com ishin mediat e internetit me numrin më të madh të raportimeve. Pasqyra për sa i përket medias së shkruara dhe elektronike është shumë e ngjashme me atë të vitit të kaluar. Në fushën e mediave të shkruara, Kosova Sot prin qartas me mbulimin e saj për dhurimet, vijuar nga Zëri dhe Epoka e re. Mediat elektronike që transmetuan numrin më të madh të raportimeve ishin RTK dhe Kohavision. Pothuajse të gjitha raportimet e regjistruara janë publikuar dhe transmetuar në mediat ditore – përjashtimi i vetëm ishte se disa media të internetit që nuk përditësohen në baza ditore janë vendosur në kategorinë e shpeshtësisë së media “të tjera”.

Në analizën e mbulimit medial, është interesante që të shihet vendosja dhe kohës e ndarë për raportime, meqë të dyja këto tregojnë rëndësinë që i kushtohet filantropisë. Për fat të keq, nuk kishte të dhëna të shumta në dispozicion për të konstatuar trende, por nga ato që ishin në dispozicion, kemi kuptuar se filantropia nuk është temë prioritare për mediat në Kosovë. Vetëm disa raportime në media të shkruara janë publikuar në pesë faqet e para, ndërsa mediat elektronike nuk kanë pasur mbulime në ballina për filantropinë. .

Për sa i përket kohëzgjatjes së raportimeve, pothuajse 95% e raportimeve në media të shkruara dhe në internet ishin me gjatësi “mesatare” (që zënin deri gjysmë faqe), ndërsa ka pasur të dhëna të pamjaftueshme nga mediat elektronike për të bërë një analizë të ngjashme.

Ndonëse numri më i madh i raportimeve mediale për filantropinë dhe transparenca më e madhe e të dhënave është më e mirë, analiza jonë tregoi se filantropia vazhdon të jetë temë anësore për mediat më 2015. Përkundër përmirësimeve të caktuara, raportimet mediale edhe më tej janë shpeshherë të paplota, dhe ndonjëherë të vështira për t’u kuptuar.

Përgjithësisht, mediat në Kosovë mbulojnë filantropinë më shumë se më parë, por në nivel të njëjtë me disa vende të tjera të rajonit. Përveç kësaj, mediat në Kosovë kryesisht kanë raportuar për filantropinë dhe nuk marrë përsipër role të tjera të mundshme (siç janë inicim i veprimeve filantropike dhe/ose veprimi në partneritet me të tjerët). Duke i pasur parasysh trendet në rajon, presim që mediat në Kosovë së shpejti të fillojnë të luajnë rol më aktiv.

Së fundi, të dhënat për 2015 tregojnë se mediat në Kosovë kanë vazhduar të krijojnë një qasje më transparente. Pas një rënie më 2014 në përqindjen e raportimeve që saktësojnë shumën e dhuruar, më 2015 mediat përsëri kanë cekur vlerën e donacionit në mbi 30% të raportimeve.

PIKAT KYÇE:



- Shumica e raportimeve për filantropinë janë botuar në media të internetit (75.3%), pasuar nga mediat e shkruara (21.9%), ndërsa mediat elektronike kanë mbetur prapa dy të parave (2.8%).
- Mediat ditore kanë botuar numrin më të madh të raportimeve.
- Në vitin 2015 mediat kombëtare zënin përqindjen më të madhe të raportimeve të publikuara me 84.4% (që ishte më pak se më 2014), gjersa mbulimi rajonal është rritur në 14.5%.
- Ndonëse raportimi në përgjithësi dhe transparenca e të dhënave janë përmirësuar, shpeshherë raportimet nuk ishin të plota. Përveç kësaj, të dhënat për kohën dhe vendin që i është kushtuar raportimeve në media tregojnë se filantropia vazhdon të jetë temë me prioritet të ulët.
- Mediat në Kosovë janë përqendruar vetëm në raportim, dhe nuk kanë marrë përsipër një rol më aktiv duke iniciuar veprime të tyre filantropike ose në partneritet me të tjerët në këtë fushë.
- Përfundimisht, pas një rënie në vitin 2014, përqindja e raportimeve ku është cekur shuma e donacionit është rritur përsëri në 30.1%.

3 | Shtojcat

3.1 | Shtojca 1: Metodologjia

Metodologjia për këtë raport është kushtëzuar nga opsionet e realizueshme për mbledhjen e të dhënave. Hulumtimi mbi këtë temë në të gjithë botën tregon se burimi i vetëm i besueshëm i informacionit mbi nivelin e dhurimeve për qëllime bamirësie mbledhet nga organet tatimore. Për shumë arsye nuk ishte e mundur që të përdoret ky burim informacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Siç u përmend më parë, Catalyst ka zgjedhur mënyra alternative të mbledhjes së të dhënave, në radhë të parë duke përdorur të dhëna nga mediat, si dhe burime të tjera të të dhënave në dispozicion. Konkretisht, të dhënat e përdorura si bazë për këtë raport janë mbledhur nga monitorimi i mediave elektronike, të shtypura dhe në internet në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor, 2014.

Janë tri kufizime kryesore për këtë metodologji. Së pari, kjo metodë nuk jep të dhëna gjithëpërfshirëse meqë mediat nuk raportojnë për të gjitha rastet e bamirësisë dhe dhurimeve. Së dyti, raportimet e mediave shpeshherë nuk i paraqesin të gjitha informatat që janë të rëndësishme për monitorimin e zhvillimit të filantropisë (më së shpeshti nuk publikojnë shumën e dhuruar dhe/ose të mbledhur). Së treti, ekziston një kufizim i mundshëm në besueshmërinë e të dhënave të publikuara nga mediat.

Kufizimi i parë nuk mund të tejkalohet në këtë kohë. Për sa i përket kufizimit të dytë dhe të tretë, Catalyst mëton t'i tejkalojë ato duke bërë analiza të ndërthurura të mediave të ndryshme⁵, dhe pastaj duke kryer hulumtime shtesë, për shembull, duke kontrolluar raportimin nga bizneset dhe organizatat jofitimprurëse (nëse ato janë në dispozicion për publikun). Përkundër këtyre kufizimeve të njohura, mendojmë se janë dy fakte që e justifikojnë analizën tonë:

- Shifrat tona, ndonëse jo të plota, paraqesin vlerën minimale për treguesit përkatës. Nëse, për shembull, diskutojmë për numrin e rasteve të bamirësisë, mund të themi me bindje që numri i paraqitur është numri minimal i rasteve që kanë ndodhur dhe se shifra e vërtetë është me siguri më e lartë. E njëjta gjë është e vërtetë për shumën në para të gatshme, akterët dhe të ngjashme. Për këtë arsye, këto të dhëna mund të përdoren **si tregues të shkallës minimale të zhvillimit të filantropisë** në një vend të caktuar.
- Vëzhgimi i vazhdueshëm do të tregojë një **rritje dhe/ose rënie të numrit dhe ndryshimit në të dhënat** që lidhen me treguesit e zgjedhur. Prandaj, monitorimi i vazhduar përgjatë viteve do të nxjerr në pah **trendet e zhvillimit të filantropisë**, si dhe trendet në raportimin e mediave mbi këtë temë.

Catalyst do të vazhdojë ta avancojë këtë metodologji. Catalyst gjithashtu planifikon të vendosë kontakte me autoritetet shtetërore (organet tatimore, si dhe zyrat e tjera me të dhëna relevante statistikore) për të diskutuar për rëndësinë e këtyre të dhënave dhe për të eksploruar mënyra për rritjen e numrit të burimeve të besueshme të të dhënave. Në kushtet aktuale, mendojmë që metodologjia mundëson informata paraprake mbi filantropinë në Kosovë.

⁵ Media të ndryshme raportojnë për në të njëjtat donacione. Kështu, duke i krahasuar të dhënat nga disa raportime të mediave, jemi në gjendje të sigurojmë të dhëna më të sakta dhe më të plota.

Faktorët dhe treguesit që tregojnë shkallën e zhvillimit të filantropisë | 3.1.1

Është e vështirë të vlerësohet shkalla e zhvillimit të filantropisë në një mjedis në të cilin nuk mblidhen të dhënat e sakta dhe ku nuk realizohet monitorimi i vazhdueshëm. Prandaj, Catalyst ka krijuar një listë fillestare të faktorëve që mund të ndihmojnë të sqarojnë aspektet e ndryshme të dhurimeve: rastet/nismat për dhurime bamirëse; metodat e mbledhjes së donacioneve në para të gatshme; temat e dhurimeve; pranuesit dhe përfituesit e donacioneve⁶; donatorët; akterët; dhe mbulimi medial⁷.

Për t'i përdorur të dhënat e mbledhura për analiza krahasuese (si mes vendeve ashtu dhe brenda një vendi të caktuar gjatë disa viteve) dhe duke i pasur parasysh faktorët e identifikuar më sipër, ishte e nevojshme që të përkufizohen treguesit sasior dhe cilësor për secilin faktor. Treguesit që i kemi përdorur janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Faktori	Treguesi
Rastet e dhurimit të bamirësisë	<ul style="list-style-type: none"> Numri i rasteve të dhurimit të bamirësisë në një periudhë njëvjeçare; Shpërndarja gjeografike (% i rasteve për rajon në relacion me gjithsej numrin e rasteve); % i rasteve të donacioneve në para të gatshme në relacion me gjithsej numrin e rasteve; % i rasteve të donacioneve në natyrë/shërbimeve në relacion me gjithsej numrin e rasteve.
Metodat e grumbullimit të donacioneve në para të gatshme	<ul style="list-style-type: none"> Grupet e ndryshme (llojet) e metodave për ngritje të fondeve për donacione në para të gatshme; % i përfaqësimit të llojeve të ndryshme të metodave; Paraqitja e metodave të reja për ngritje të fondeve/donacioneve në para të gatshme.
Qëllimi i rasteve të dhurimit të bamirësisë	<ul style="list-style-type: none"> Tema apo qëllimi i mbështetjes; Numri (në %) i rasteve sipas qëllimit; Paraqitja e temave të reja; Përdorimi i donacioneve sipas temës.
Pranuesit dhe përfituesit e donacionit	<ul style="list-style-type: none"> Llojet e pranuesve të donacioneve; Numri i rasteve që përfshijnë pranues në sektorin shtetëror (% në relacion me gjithsej numrin); Numri i rasteve që përfshijnë pranues në sektorin civil (% në relacion me gjithsej numrin); Numri i rasteve që përfshijnë pranues nga grupe të tjera (% në relacion me gjithsej numrin); Llojet e përfituesve; Numri i rasteve të drejtuara për grupe të ndryshme të përfituesve (% në relacion me gjithsej numrin e rasteve); Paraqitja dhe numri i grupeve të reja të përfituesve.
Donatorët	<ul style="list-style-type: none"> Numri i rasteve sipas llojit të donatorit (% në relacion me gjithsej numrin e rasteve); Numri i rasteve sipas pranuesve të ndryshëm dhe sipas llojit të donatorit; Numri i rasteve sipas temës dhe sipas llojit të donatorit; Numri i rasteve sipas grupeve të përfituesve dhe sipas llojit të donatorit.
Vlera e donacioneve për qëllime bamirësie	<ul style="list-style-type: none"> Gjithsej vlera e donacioneve të bamirësisë; % i rasteve me një shumë të regjistruar të donacionit; % shumës së dhuruar sipas llojit të donatorit; % shumës së dhuruar sipas llojit të pranuesit; % shumës së dhuruar sipas temës.
Akterët	<ul style="list-style-type: none"> Lloji dhe numri i akterëve të ndryshëm; Paraqitja e akterëve të rinj.
Mediat	<ul style="list-style-type: none"> Gjithsej numri i raportimeve mediale; Numri (në %) i raportimeve mediale sipas llojit të mediave; Numri (në %) sipas mbulimit territorial (nacional, rajonal, lokal); Numri i raportimeve të trajtuara si substanciale sipas llojit të mediave (të shtypura, elektronike).

Është e mundur që gjatë përgatitjes së hulumtimit tonë, i cili shpresojmë se do të vazhdojë për disa vite, disa prej faktorëve që do t'i analizojmë do të pësojnë ndryshim ose të marrin fokus më të mprehtë, dhe është e mundur që do të paraqiten faktorë të rinj. Për momentin, besojmë që faktorët e listuar më sipër ofrojnë një pikënisje të mirë në përcaktimin e gjendjes së bamirësisë në secilin prej vendeve që monitorojmë.

⁶ Përderisa këto dy kategori mund të duken të njëjta, ato shumë shpesh ndryshojnë në praktikë. Pranuesit e donacioneve zakonisht janë personat juridik të regjistruar (si institucionet, organizatat jofitimprurëse, qeveritë lokale, etj.) që kërkojnë mbështetje për një qëllim të caktuar. Pranuesit gjithashtu mund të jenë individë apo familje. Përfituesit mund të jenë grupe të ndryshme në dobi të të cilëve është kërkuar mbështetja. Për shembull, nëse pranuesi i një donacioni është një spital lokal, përfituesit janë njerëzit e atij komuniteti lokal. Nëse pranuesi i donacionit është një shkollë, përfituesit janë fëmijë/të rinjtë e një moshe të caktuar që ndjekin mësimin në atë shkollë. Nëse pranuesi i donacionit është një organizatë jofitimprurëse që punon me personat me aftësi të kufizuara, përfituesit janë njerëz me aftësi të kufizuara, etj. Informata më të hollësishme për përfituesit e donacioneve sugjerojnë perceptimin publik se kush "meriton" mbështetjen dhe kujt i besojnë. Gama e përfituesve tregon se cilat grupe janë konsideruar të jenë të cenueshme (në çfarëdo mënyre), nga publiku dhe, me kalimin e kohës, do të tregojnë se është ndryshuar vetëdijesimi publik mbi çështjen.

⁷ Akterët nuk janë vetëm donatorët, por edhe ata që apelojnë për ndihmë dhe ata të cilët, në çfarëdo mënyre, marrin pjesë në filantropi. Është rregull i përgjithshëm që rritja në numrin e akterëve kuptohet se do të çojë përpara ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë dhe rolin e bamirësisë në shoqëri.

3.2 | Ndryshimet në kuadrin ligjor-fiskal

Gjatë vitit 2015, nuk ka pasur ndryshime në kuadrin ligjor fiskal për dhurimet në Kosovë. Rrjedhimisht, në vijim vetëm kemi paraqitur një përmbledhje të çështjeve ende të pazgjidhura tatimore. Kjo pasqyrë është nxjerrë nga botimi "Rregulloret tatimore me rëndësi për zhvillimin e filantropisë në vendet e Evropës Juglindore", përgatitur nga Dr. Dragan Golubovic, për nevojat e rrjetit SIGN. Në këtë Shtojcë i kemi paraqitur vetëm informatat që kanë të bëjnë me Kosovën. Publikimi i plotë është në dispozicion në faqen

<http://www.sign-network.org/activities/advocacy-for-policy-changes>

Tatimi në të ardhurat të korporatave. "Organizatave joqeveritare" të cilat kanë fituar statusin e përfitimit publik sipas **Ligjit për Lirinë e Asociimit** (që qartas vlen edhe për fondacionet)⁸ lirohen nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave, për aq kohë sa ata i shfrytëzojnë të ardhurat e tyre ekskluzivisht për avancimin e qëllimeve të tyre të përfitimit publik (neni 7 (1) Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave)⁹.

Korporatat mund të zbresin deri në 5% të të ardhurave të tyre të tatueshme për donacionet brenda vendit për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe qëllime sportive (neni 10 (1), ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave). Pranuesit e mundshëm të donacioneve përfshijnë OJQ-të të cilat kanë të fituar statusin e përfitimit publik sipas rregullores kornizë, dhe institucionet publike në fushat e cekura më lart (neni 10 (2), ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave). Zbritja e lejueshme nuk përfshinë kontributin nga i cili direkt apo indirekt përfitojnë donatorët ose personat e lidhur me donatorin (neni 10 (3), ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave). Ligji nuk trajton çështjen e statusit tatimor të **granteve institucionale** (donacioneve) për OJQ-të të cilat kanë status të përfitimit publik.

Tatimi mbi të ardhurat personale. Dhurimi nga individë për qëllime të kualifikuara të përfitimit publik janë të zbritshme sipas të njëjtave kushte të përcaktuara për korporatat (neni 28 (1), ligji për tatimin në të ardhurat personale)¹⁰.

Tatimi për dhuratat. Dhuratat në përgjithësi nuk janë subjekt i tatimeve. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është duke punuar në një projektligj për sponsorizimin i cili do të mund ta trajtonte këtë çështje në një mënyrë.

Statusi i përfitimit publik. Rregullat për statusin e përfitimit publik janë të përcaktuara në Ligjin për lirinë e asociimit. Një OJQ e cila ka fituar statusin e personit juridik mund të aplikojë pranë organit kompetent për "statusin e përfitimit publik", i cili ki jep të drejtë organizatës në përfitime tatimore (supra) dhe përfitime fiskale, si dhe duhet t'i nënshtrohet kërkesave të caktuara të raportimit (neni 17, Ligji për lirinë e asociimit). Një OJQ që është e organizuar dhe vepron për të realizuar një apo më shumë nga aktivitetet vijuese si veprimtari kryesore mund të aplikojë për status të përfituesit publik: ndihmë dhe përkrahje humanitare, përkrahje për personat me aftësi të kufizuara, bamirësi, arsimit, shëndetësisë, kulturës, mbrojtjen e mjedisit apo mbrojtje, rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik, promovimin e të drejtave të njeriut, promovimin e praktikave demokratike dhe shoqërisë civile, promovimi i barazisë gjinore, apo çfarëdo veprimtarie tjetër që i shërben së mirës së publikut (Neni 17 (1), Ligji për Lirinë e Asociimit).

Veprimtaria e OJQ-së përfshinë veprimtari për të mirën e publikut vetëm në rast se përfitime të konsiderueshme sigurohen falas ose më lirë se vlera e tregut për grupe ose individë në kushte të pavolitshme (neni 17 (2), ligji për lirinë e asociimit). OJQ-ja të cilës i është lejuar statusi i përfituesit publik, duhet t'i paraqesë raport vjetor për veprimet dhe aktivitetet e saj për ta mbajtur këtë status (neni 18 (1), ligji për lirinë e asociimit). Kërkesat e veçanta të auditimit janë të përcaktuara për të gjitha OJQ-të të ardhurat vjetore të të cilave tejkalojnë afërsisht 100,000 € (neni 18 (9), ligji për lirinë e asociimit). Statusi i përfitimit publik mund të pezullohet nëse OJQ-ja nuk arrin të paraqesë raport të plotë vjetor ose nëse OJQ-ja më nuk i plotëson kushtet për status të përfitimit publik (neni 19 (1) (3) ligji për lirinë e asociimit). Nëse statusi pezullohet apo tërhiqet, OJQ-ja duhet të presë tri vite për aplikuar sërish¹¹.

8 03 / L-134 që ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2011. OJQ-të në Kosovë veprojnë në formë të shoqatave dhe fondacioneve.

9 Ligji nr. 04/L-103, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave; shpallur me dekretin nr. DL-019-2012 të datës 17 maj 2012.

10 Ligji nr. 03/L-161 mbi tatimin në të ardhura personale shpallur me dekretin nr. DL-020-2012 të datës 17 maj 2012.

11 Shënim i USIG për Kosovën, shtator 2012, në dispozicion në <http://usig.org/countryinfo/kosovo.asp>

Shfrytëzimi i donacioneve Ligji nuk parashikon afat specifik kohor brenda të cilit duhet të shfrytëzohet një donacion, si dhe nuk përcakton ndonjë prag për shpenzimet rrjedhëse të organizatës. Këto çështje mund të adresohet në një marrëveshje për donacionin. Megjithatë, për sa i përket afatit kohor brenda të cilit duhet të shfrytëzohen donacionet, në mungesë të rregullave statutores të bartjes (infra), statusi tatimor i donacioneve të cilat marrëveshja i lejon që të barten tek vitet pasuese fiskale mbetet i paqartë.

PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE TË PAZGJIDHURA NË KOSOVË

TATIMI MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS:	TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE:
<ul style="list-style-type: none"> Listë e definuar ngushtë e aktivitete në përfitim publik; Listë përfundimtare, jo ilustruese; Lista nuk përputhet me atë të parashikuar në rregulloren kornizë; Nuk është e qartë nëse donacionet në natyrë janë të zbritshme në tatime; Nuk ka rregulla specifike në lidhje me grantet institucionale të OJQ-ve; Nuk ka rregulla specifike të bartjes për donacionet; Nuk ka rregulla specifike për shpenzimet rrjedhëse të organizatës. 	<ul style="list-style-type: none"> Listë e definuar ngushtë e aktivitete në përfitim publik; Listë përfundimtare, jo ilustruese; Lista nuk përputhet me atë të parashikuar në rregulloren kornizë; Nuk është e qartë nëse donacionet në natyrë janë të zbritshme në tatime; Nuk ka rregulla specifike në lidhje me grantet institucionale të OJQ-ve; Nuk ka rregulla specifike të bartjes për donacionet; Nuk ka rregulla specifike për shpenzimet rrjedhëse të organizatës.

Hulumtimi është realizuar nga:

catalyst

Catalyst Balkans
Takovska 38
Beograd, Serbi
www.catalystbalkans.org

Hulumtimi është mbështetur nga:



Hulumtimi është realizuar nga:

